



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **104**

Prishtinë, më 4.3.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Boban Todorović dhe Nijazi Idrizi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 25.2.2013,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndërtesat në bashkëpronësi,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale,
5. Grupet punuese për dy projektligje,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me shtesën rreth shqyrtimit edhe të dy Projektligjeve që janë për leximin e parë (ndërtimet pa leje dhe blegtorja), projektin e komisionit evropian për Brezovicë si dhe raportimin rreth shfrytëzimit të zhavorit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.2.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25.2.2013, dhe kërkoi që procesverbali të plotësohet me të dhënat më detale në pikën të ndryshme për ndryshimet që janë bërë tek Projektligji për ujëra.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndërtesat në bashkëpronësi

Kryetari Nait Hasani falënderoi të ftuarit (Sekretarin e MMPH) dhe bashkëpunëtorët që janë angazhuar në këtë Projektligj duke filluar shqyrtimin e vërejtjeve një nga një rreth projektligjit në fjalë. Paraprakisht **Salih Morina** tha se projekti ka pësuar shumë ndryshime nga vërejtjet e dërguara, ndaj shfaqti brengën mos po kundërshtohet në leximin e dytë për shkak të tejkalimit të amendamenteve përtej 50% si është rregulluar sipas Rregullores së Kuvendit. **Kryetari** potencoi punën dymujore me këtë projekt dhe faktin se këto ndryshime janë me pajtimin e propozuesit të ligjit ndaj shfaqti mendimin se nuk do të ndodhë diçka e tillë, edhe pse si tha ai Komisioni vendosë. Në vazhdim komisioni procedoi me vërejtjet e MMPH dhe projektit të BQK në krye me Bill Donovan duke analizuar nenet një nga një dhe duke ndërhyrë si vijon :

- Përkufizimet sa i përket definimit të MMPH duhet të figuroi si “Ministria përkatëse...”,
- **Liburn Aliu** reagoi tek Amendamenti 5 lidhur me sqarimin rreth tarracave të përbashkëta dhe lojërave të ndryshme që janë nëpër këto bashkëpronësi, **Daut Haradinaj** reagoi rreth shfrytëzimit të muraleve nëpër banesa për reklamime etj, **Afërdita Berisha** rreth rindërtimeve (shtimi i kateve etj),
- në disa raste (Am.27, neni 28, paragr.3) në amendamentet e propozuara në vend të fjalës “seksioni” të shkruhet “neni”,
- Në Amendamentin 25 te Neni 27, në paragrafin 3 fjala “Takimet speciale” zëvendësohet me “Takimet e jashtëzakonshme” ndërsa fjala “mund” fshihet,
- Amendamenti 31, nenet e shtuara, për mbledhjen e radhës të ridefinohen nga MMPH duke i shkurtuar ato mundësisht,
- Amendamenti 45, Neni 42, në paragrafin 1 “komitetit të pronarëve” zëvendësohet me “shoqata e pronarëve”,
- Te Neni 46 (44), në paragrafin 1, fjala e parë “Mbikëqyrjen e” zëvendësohet me “Përgjegjës për”, si dhe në vazhdim “dispozitave të miratuara” zëvendësohet me “aktet nënligjore”,
- Te Neni 47 (45) riformulohet Paragrafi 2 : **Në territoret që janë nën kompetencën e Ministrisë, mbikëqyrjen inspektuese e bënë Inspektorati i Ministrisë.**

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale

Kryetari ftoi Komisionin për shqyrtimin e vërejtjeve nga Komisionet e përhershme për të cilat u konstatua se do të vendosë mbledhja plenare. Amendamentet e Komisionit për Komunitete u konstatuan se janë amendamente në amendamentet e këtij komisioni por jo në projektligj, ndaj këto 4 amendamente u mbështetën dhe do të bëhen përmirësimet e kërkuara nga ky komision : intervenimi rreth fjalës Kuvendi ku duhet të shtohet edhe i Republikës së Kosovës, emërtimet e memorialëve nëpër Komuna të zyrtarizohen simbas Ligjit për komunat, gjithashtu Lista e komplekseve të plotësohet nga Komunat (për këtë ka vendosur me amendament edhe ky komision), dhe në fund sa i përket memorialit të masakrës nga Gjeneral Janković të hiqet fjala “kriminel”. Projektligji u përcjell në leximin e dytë.

5. Caktimi i grupeve punuese

Kjo pikë u shqyrtua bashkërisht me pikën e fundit ku paraprakisht u përcollën dy projektligje për leximin e parë (Ndërtimet pa leje dhe Blegtozia), ndërkaq rreth Projektligjit për Planifikim Hapësinor dhe Projektligjit për Inspektorat u caktua si grup punues i tërë komisioni (duke përfshirë edhe Ndërtimet pa leje) pasi që ndërlidhen në mes vedy.

1. Rreth pikës shtesë së rendit të ditës për projektin e Brezovicës, fjalën e mori **Liburn Aliu** i cili konstatoi se për këtë rajon KE (komisioni evropian) ka përgatit projektin ideor që i përket zonës strikte për të cilin duhet të jap pëlqimin Qeveria, fjala është për rajonin e pabanuar ndërmjet Prevallës dhe Brezovicës ku do të ndërtohen dy projekte, njëra staza për skijim dhe tjetra fshati turistik të cilin ai e kundërshtoi ngase me këtë do të involvohej biznesi dhe do të na krijohet edhe një Prevallë. Në mënyrë që të ndermirën veprimet nga ky komision, ai sugjeroi fillimisht takimin me Ministren Mimoza Kusari e cila do të informoi komisionin a janë respektuar përgjigjet e MMPH lidhur me këtë, ngase kemi të bëjmë me cenimin e natyrës. Duke u ndërlidhur **Arben Çitaku** tha se MMPH është në rrjedha të kësaj por leje apo pëlqim ende nuk ka, për këtë duhet të vendos Qeveria. MMPH lëshon pëlqimin mjedisor vetëm kur gjendet investitori. **Liburn Aliu** insistoi që lidhur me këtë të respektohen së pari standardet evropiane ngase shkelen ligjet evropiane, propozoi të ftohen vendorët por edhe ndërkombëtarët dhe të merren sqarimet e nevojshme për këtë komision. **Kryetari** mbështeti nismën dhe shtoi se do të kërkohej informatat e duhura për të proceduar këtë çështje në Komision.

2. Rreth çështjes së dytë për rendin e ditës, **Liburn Aliu** potencoi se “Bechtel Enka” nuk ka marr pëlqimin e VNM rreth eksploatimit të zhavorrit në fshatin Graboc i ulët, në ndërkohë që me leje për hulumtim ka filluar përgatitjet për eksploatim, ndërsa **Arben Çitaku** tha se nga kjo kompani është aplikuar për shfrytëzim ndërkaq, më tutje do të shqyrtohen kushtet ligjore dhe do ti jepet pëlqimi mjedisor, ngase poçes nuk epet leja për atë pozicion ku është gjete zhavorri i kërkuar, buxhetit do ti kushtojë eksploatimi në vend tjetër dhe kjo do të ketë efekt ekonomik, mirëpo **Liburn Aliu** insistoi në ruajtjen e biodiversitetit ngase në fund dalin dëmet edhe më të larta për shtetin nëse ajo shkatërrohet.

Mbledhja përfundoi në orën 14,30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani